

# AKTI I THEMELIMIT

i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“BENOIT-sh.p.k”

## Kreu I

**Neni 1:  
Krijimi**

Sot, më date 01/09/2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **BENOIT-sh.p.k**

Themeluesit e shoqërisë janë:

**Koço QELESHI**, i biri i Ili dhe Liljana, lindur me 25.07.1983 Lezhe, banues ne Tirane, Rruga Todi Shkurti, Pallati Grand, Shkalla 5, Ap Nr. 28 mbajtes i **ID I307251110**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Arben GJOKA**, i biri i Hysni dhe Vashe, lindur me 12/07/1960 Peshkopi, banues ne Tirane, Rruga Mihal Grameno, Pallati Nr.95, Shkalla 5, Njesia Nr.1 mbajtes i **ID I00225089M**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne vijim referuar se bashku si “**Ortak**”

Palet e sipercituar perpiluan kete Akt Themelimi nepermjet te cilit deklarojne me vullet te lire dhe te plote dhe ne pajtim me Kushtetuten e Rrepublikes se Shqiperise dhe Kodit Civil ne Shqiperi, me ligjin 9901 Date 14/04/2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare, me ligjin 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit, me ate te ligjit Doganor, Fiskal e Tatimor, dhe Autoritetit perkates sipas objektit te shoqerise, krijon shoqerine Tregetare me pergjegjesi te Kufizuar “**BENOIT-Sh.p.k**”

**Neni 2:  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e Bar Kafes, Njesi sherbimi!

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit

**Neni 4:  
Selia**

Shoqëria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, me adrese, Rruga Mihal Grameno, Pallati Nr. 95, Njesia Nr.1, zona kadastrale Nr. 8160. Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyre perfaqesie, dege, te krijojë filjale si brenda ashtu edhe jashte Rrepublikes se Shqiperise vetem me vendimin e te dy Ortakeve.

Adresa e faqes se internetit te kompanise eshte [benoit.2021@yahoo.com](mailto:benoit.2021@yahoo.com)

Nr.Tel 0674103282

Emri Tregetar: “BENOIT sh.p.k”



## Kreu II Kapitali

### Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 Lekë, i ndare ne dy kuota te barabarta me vlere nominale 5000 leke per kuote. Te dy Ortaket e Shoqerise kane nenshkruar dhe kane derdhur pjesen e tyre te kapitalit. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin eshoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Koço QELESHI**: Zoterues i 5.000 leke nje kuote me vlerë të përgjithshme, qe perben nje kuote me vlerë të përgjithshme 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Arben GJOKA**: Zoterues i 5.000 leke nje kuote me vlerë të përgjithshme, qe perben nje kuote me vlerë të përgjithshme 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

### Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te thirrur nga Administratori per te marre vendim rreth ketij projekti.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 5 te ketij Statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar deri ne nje vlere minimale. Ne rast mos zbatimi te ketij paragrafi, çdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise, kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

### Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontratat duhet te jene me shkrim.

Pjesët e kapitalit te fituar janë lirisht të transferueshme edhe ne rrugë dhurimi apo konvertimi ne pasuri te paluajtshme.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise dhe detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave deri ne çastin e rregjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit. Rregjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarres**

Arganet vendimmarres te shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori;

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

**Neni 9**  
**Asambleja e Pergjithshme**

Anetaret e Asamblese se Pergjithshme jane Ortaket **Zt. Koço QELESHI** (Administrator) dhe **Zt. Arben Gjoka** (Ortaku).

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshirë pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;
- j) percaktimin e politikave tregtare te kompanise;

**Neni 10**  
**Administrimi**

**ADMINISTRATORI** i Shoqerise eshte **Zt. Koço QELESHI** i biri i Ili dhe Liljana, shtetas Shqiptar dhe mbajtes i **ID I307251110**, i emeruar ne kete detyre per nje afat 5-vjeçar me te drejte ripertesitje.

- Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme ne rast kur: Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose egziston rreziku qe aktivitetet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkushme brenda 3-muajve ne vazhdim.
- Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem.
- Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjithe personave fizik dhe juridik, publik dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshire ketu autoritetet shteterore shqiptare apo te huaj.
- Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te trete ne emer te Shoqerise, ne te gjithë rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve.
- Administratori angazhon shoqerine ne maredhenie me te trete nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merrr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te trette e dinin qe akti i

administratorit i kalonte objektin e shoqërise ose kur te tretet nuk mund ta injorojne kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftushme.

## Neni 11 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) i delegon menaxherit/es te kompanise dhe ekonomistit/es te drejttat per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqërise.
- ç) nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 12 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori dhe Ortaku jane pergjegjes, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljetë ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1.
  - a) Të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një ortak, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### **Kreu IV Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 14 Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'ishqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 15 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi iveprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 16**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 17**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata e shkallës së parë Tiranë.

**Neni 19**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u reduktua në 5 kapituj në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Ky akt i mesipër u miratua akt për akt dhe nën për nën nga të dy themeluesit e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “BENOIT-sh.p.k” dhe nënshkruhet prej tyre në të gjithë kopjet duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën origjinale.

**O R T A K E T**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“BENOIT-sh.p.k”**

**ORTAKU**

**Zt. Koço QELESHI**

**ORTAKU**

**Zt. Arben GJOKA**